

**Përditësim i RIO-s së Albtelecom në përputhje me VKD nr. 1742 dt.  
20.12.2011**

**1. Në nenin 4 “Baza Juridike”, shtohet pika 2/2; 3/4; 3/5; 3/6; 3/7 si dhe 5/k dhe shtohet fjalia tek pika 5/i dhe pika 6 si më poshtë:**

*2/2 Vendimin nr. 1742 dt. 20.12.2011 për “Shfuqizimin e VKD nr. 1439 dt. 03.11.2010 “Disa ndryshime në VKD nr. 1348 dt. 26.07.2010 ‘Për Përcaktimin esipërmarrësit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse””*

*3/4 Rregulloren nr 16, date 16.04.2010 “Per treguesit e cilesise” miratuar me VKD 1256, date 16.04.2010*

*3/5 Rregulloren nr 18, date 11.06.2010 “Per procedurat e zgjidhjes se mosmarreshjeve”, miratuar me VKD nr 1296, date 11.06.2010*

*3/6 Rregulloren “Per portabilitetin e numrit” miratuar me VKD nr 1219, date 7.4.2010*

*3/7 VKD nr 1318 date 14.06.2010 “Per miratimin e specifikimeve teknike per portabilitetin e numrit”*

*5/i Parashikime për trafikun që do të shkëmbehet të jepet i detajuar sic është parashikuar në Aneks 8 “Parashikime dhe Porosia për Kapacitete” pika 3*

*5/k Historikun e te dhenave per trafikun e gjeneruar nga abonentet e Operatorit Perfitues (origjinim/tranzitim/terminim) sipas raporteve te dorezuara ne AKEP periodikisht*

*6 kërkesa do të konsiderohet e tillë vetëm pas plotësimit me të gjithë dokumentat dhe informacionet e sipërpërmendura si dhe të dhënat e detajuara të specifikuara në nenin 9, pika 2/1.*

**2. Në nenin 9 “Interkoneksioni me rrjetin Albtelecom”, shtohet pika 2/1 si më poshtë:**

*2/1 ndërmjet të dhënave të detajuara që duhet të paraqiten së bashku me kërkesën për interkoneksion janë edhe:*

- a. Informacionin lidhur me Kodin(et) e Pikave te Sinjalizimit (SPC kombetare), caktuar nga AKEP sipas rekomandimeve te SS7.*
- b. Operatori Perfitues që kërkon të terminojë trafik ndërkombetar në rrjetin e Albtelecom, duhet të disponojë:*
  - ISPC (International SPC) te caktuar nga AKEP sipas rekomandimeve te SS7*
  - Teknologji transmetimi TDM (Time Division Multiplexing) nepermjet shtresës fizike të fibrës me rrugëzim të mbrojtur e të sigurtë.*

- c. *Informacionin lidhur me numrin e abonentëve ekzistues të Operatorit Përfitues në momentin e paraqitjes së kërkesës për interkoneksion, të vërtetuar nga evidencat përkatëse*
- d. *Informacionin lidhur me parametrat e cilësisë sipas nenit 5 të Rregullores për Akses dhe Interkoneksion dhe Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit bashkëngjitur Marrëveshjes së Interkoneksionit*
- e. *Dokumentacionin përkatës nga AKEP lidhur me aftësinë për të kryer rrugëzimin e duhur të thirrjeve, sipas përcaktimeve të Rregullores “Për Portabilitetin e Numrit”*

**3. Në Aneks 1 “Përkufizime”, ndryshon përkufizimi i shërbimit të terminimit në rrjetin Albtelecom dhe shtohet përkufizimi i shërbimit të terminimit të trafikut ndërkombëtar si më poshtë:**

*Shërbimi Terminimit në Albtelecom*

Shërbimi nëpërmjet të cilit Albtelecom, në emër të Operatorit përfitues përcjell Thirrjet nga Pika e Interkoneksionit për në një Pikë fundore të Rrjetit të tij në Republikën e Shqipërisë, të identifikuar nëpërmjet numrave gjeografike të abonentëve/pajtimtarëve të Albtelecom (hiqet togfjalëshi: *sipas planit të numeracionit*)

*“Shërbimi i Terminimit të trafikut ndërkombëtar në Albtelecom”*

Shërbimi nëpërmjet të cilit Albtelecom, në emër të Operatorit Përfitues përcjell Thirrjet ndërkombëtare, të tranzituara nga ky i fundit, nga Pika e Interkoneksionit për trafikun ndërkombëtar për në një Pikë fundore të Rrjetit të tij në Republikën e Shqipërisë, të identifikuar nëpërmjet numrave të abonentëve/pajtimtarëve të *Albtelecom*

**4. Në Aneks 6 “Cështje Teknike”, pika 4.1 shtohet fjalia si më poshtë dhe shtohet pika 4.4 si më poshtë:**

*4.1 ...Ky kapacitet konfigurohet i ndarë sipas kategorisë së trafikut, i dedikuar vecmas për trafik kombëtar dhe vecmas për atë ndërkombëtar.*

*4.4 Albtelecom rezervon të drejtën të shkëpusë kapacitetin e lidhur për trafikun ndërkombëtar, nëse Operatori Përfitues nuk e përdor fare këtë kapacitet për një periudhë 2 (dy mujore)*

**5. Në Aneks 6 “Cështje Teknike”, pika 7.3 shtohet fjalia si më poshtë:**

*Kodi Ndërkombëtar i Pikës së Sinjalizimit (International Signaling Point Code-ISPC) i centralit të Operatorit Përfitues është:*

*ISPC\_\_\_\_\_*